

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit M.Sh., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë- Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.nr.64/2018 të datës 31.01.2018, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit gjyqësor **me datën 25.03.2019**, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Bajram Kryeziut, përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar K.-Distrikti në Gjakovë, A. K. si dhe i akuzuarit M. Sh., në të njëjtën ditë mori dhe shpalli dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit:

M.SH., nga i ati R. , e ëma N. , e gjinisë C. data e lindjes ... në Gj., ku edhe tani banon në rrugën “... ” pn, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, është mirëmbajtës i elektrikes në spitalin “I. G.” gjendjes së mesme ekonomik, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës me numër personal: .

Në kuptim të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së,

REFUZOHET AKUZA

Me datën të pavërtetuar deri me datën 24.02.2017 me qëllim që vetit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm në mënyrë të pa autorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike në kundërshtim me neni 61 par.1 nënpar.1.1 të Ligjit për energjinë elektrike nr. 5/L-085, të Ligjit për Energjinë Elektrike GZRK nr.26/21 ,Korrik 2016 nga verifikimi në Qendrën e Kalibrimit është konstatuar se në shifrën DGJ-...., njësorin elektrik nr....., e ka ndaluar ku gjatë matjes me amper-dara shihet se ka shpenzim të energjisë elektrike mirëpo e njëjta nuk regjistrohet nga njëtori i manipuluar, me këtë veprim ka penguar regjistrimin e saktë të energjisë elektrike, me ç’rast të dëmtuarës K.-D. i Rrj.-D. në Gj., i ka shkaktuar dëme në shumë prej 964,21 Euro.

Këso dore kishte për të kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Për shkak se Prokurori i shtetit i Prokurorisë Themelore në Gjakovë, në shqyrtimin fillestar është tërhequr nga akuza.

E dëmtuara K.-D.në Gj., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Shpenzimet e procedurës penale bijën në llogari të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP.nr.64/2018 të datës 31.01.2018, kundër të akuzuarit M.Sh., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Gjatë seancës publike të shqyrtimit gjyqësor të datës 25.03.2019, Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu, ka deklaruar se: pas dëgjimit të dëshmitarit F.Z.u vërtetua një gjendje tjetër faktike se i njëjti është shfrytëzues i banesës në rrugën “.” të cilën banesë e ka blerë nga nëna e tij dhe kjo në bazë të kontratës për shitblerje e patundshmërisë në pronësi Etazhe me numër LRP.nr.... të datës 29.12.2016 cka edhe nga edhe nga deklaratë e dëshmitarit F. Z. u vërtetua se banesa nga ana e tij është shfrytëzuar prej -6 muajve para nënshkrimit të kësaj kontrate me cka vërtetohet se i akuzuari M.Sh. nuk është kryerësi i veprës penale për të cilën ngarkohet nga se në kohën kur është bërë kontrolli i K.-it por edhe më parë nuk ka qenë shfrytëzues i kësaj banese dhe në momentin e dhënies së banesës i ka pasur të kryera të gjitha obligimet ndaj K.S-it. Andaj deklaroj se tërhiqem nga aktakuza kundër të akuzuarit M.Sh. nga Gjakova, i akuzuari sipas aktakuzës me numër PP.nr.64/2018, të datës: 31.01.2018 për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së në mungesë të provave. E udhëzoi të dëmtuarin K. që ndaj F. Z.i si shfrytëzues i këtij njëtori të ngritë kallëzim të ri penal për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së

Duke pas parasysh se Prokurori i shtetit është tërhequr nga aktakuza dhe nga ndjekja penale gjatë shqyrtim gjyqësor kundër të akuzuarit M. Sh. nga Gj., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, gjykata në kuptim të nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, mori aktgjykim refuzues në këtë çështje penale dhe vendosi si në dispozitivin të këtij aktgjykimi, pasi që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me këtë dispozitë ligjore.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par.3 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u murr në kuptim të nenit 454 par.1 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i Përgjithshëm -
P.nr.76/18, më datë 25.03.2019

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mentor Bajraktari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.